



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:082068

Datë: 14.06.2019

Numri i dokumentit: 00358827

PKR.nr. 45/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti Për Krime të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues, Zyhdi Haziri, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit Q. M., nga fsh. Livoq i Ulët, Komuna e Gjilanit, të cilin me autorizim e mbron av. Halit Azemi nga Gjilani, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr. 55/2019, të datës 28.05.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 11.06.2019, bie dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari Q. M., nga i ati dhe nëna, e lindur, i lindur më datë 30.07.1966, me numër personal 1012795692, në fshatin Livoq i Ulët, K.Gjilanit ku edhe jeton, i martuar, menaxher në Real Sport SHK ‘.....’ baba i pesë fëmijëve i pa punësuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar edhe më parë për vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më datë 22.03.2019, rreth orës 12:30h në Gjilan, në Rr. Idriz Seferi në vendin e tij të punës në kazino ‘.....’ gjatë një bastisje të kryer nga policia e Kosovës tek i njëjti janë gjetur dhe konfiskuar dy armë zjarri dhe atë një revole e tipit ‘Cervena Zastava’ me nr. serik 58519, dhe një revole me gazë e markës Ecol Special E 99, me nr.serik EV17120228, si dhe 11 copë fishekë të cal.9 mm të revolës Cerverna Zastava dhe dy fishekë të revolës Ecol Special, të cilat armë i ka mbajtur në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët.

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Me çka ka kryer veprën penale:mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi.1 të KPRK-së

Andaj, kryetari i trupit gjykues, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7, 17,21,41, 42, 43,46, 62 paragrafi 2 nënparagrafi 7,73, 74, të KPRK-së, si dhe nenit 247, 365, dhe të nenit 451 të Kodit të Procedurës Penale,¹ të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të akuzuarit Q. M., i shqiptohet dënim me gjobë, në shumë prej **400(katërqind) €**, i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, në të kundërtën ashtu që një (1) ditë burgu do të barazohet me 20 euro të dënimit me gjobë, dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej **16(gjashtëmbëdhjetë) muajëve**.

Të akuzuarit i shqiptohet edhe denimi plotësues konfikimi i arëmëve Ecol Special E 99, me nr.serik EV17120228, si dhe 11 copë fishekë të cal.9 mm të revolës Cerverna Zastava dhe dy fishekë të revolës Ecol Specail.

Obligohet i akuzuari që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej **25 (njëzetepesë) euro**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit Q. M., për shkak të veprës penale :mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi.1 të KPRK-së. Prokuroria e Shtetit, më datë 30.05.2019, ka deponuar në gjykat marrëveshjen për pranimin e fajësisë në mes të akuzuarin Qamil Mehmeti dhe mbrojtësin e tij me autorizim av. Halit Azemi, me Prokurorin Themelore në Gjilan Departamenti për Krime të Rënda si dhe për sanksionin penal gjatë fjalës.

2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datë 11.06.2019, trupit gjykues, pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të të pandehurit, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, avokatin Halit Azemi, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i pandehuri Qamil Mehmeti, me dashje i ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprave penale

Me dashje është kryer vepra penale kushdo që mbanë në pronësi ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) € ose me burgim deri në pesë vite e cila parashihet në nenin 374 par. 1 të KPRK-së

5. Vendimi për shpalljen fajtor të të pandehurit

Kryetari i trupit gjykues e ka shpallur fajtor të pandehurin Q. M., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi.1 të KPRK-së, i njëjti i përmbanë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve

Trupit gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimeve, ka vlerësuar se duhet të aprovohet rekomandimi i paraqitur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë që ndaj të pandehurit Q. M., me të cilën është parashikuar shqiptimi të dënimit të lartcekur në dënim me gjobë, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit, kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenet 73 deri 76 të KPRK. Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës kryetari i trupit gjykues e ka shqiptuar dënimin, është fakti se i pandehuri ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda.

Gjithashtu, si rrethana posaçërisht lehtësuese, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe faktin se i pandehuri ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit; se me marrëveshje pranimin e fajësisë e ka bërë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale; se i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale; se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale; se sipas deklaratës së të pandehurit, të cilës kryetari i trupit gjykues ja fali besimin, i njëjti është familjar. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i pandehuri me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale. Po ashtu, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të të pandehurit.

7. Shqiptimi i dënimeve në harmoni me peshën e veprave penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimeve të shqiptuara

Sipas bindjes trupit gjykues, dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit Q. M., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lart, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Përveç këtyre, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, trupi gjykues e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të të pandehurit.

Trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Trupi gjykues duke u bazuar në nenin 46 të KPRK, ka vendosur që nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të pandehurit, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të llogariten me 20 (njëzet) euro të dënimit me gjobë. Nëse i pandehuri nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata me pëlqimin e të pandehurit mund ta zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgu do të barazohet me 20 euro të dënimit me gjobë, dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej **16(gjashtëmbëdhjetë) muajëve.**

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor, në shumë prej 25 (njëzetepesë) euro në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR. 45/19 e dt. **11.06.2019**

Sekretare juridike
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues
Zyhdi Haziri

KËSHILLË JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi nuk mund të paraqitet ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e as për shkak të vendimit për dënimin.